



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 472 Prot.

Tiranë, më 19.03. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 70, datë 19 .03. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën Nr. 254 regj, datë 23.11.2023, të paraqitur nga Xh.H kundër kundër ProAqua Internatinal si dhe personit intervistues, në cilësi personale, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “identitetit gjinor”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese informon se, në datë 20.11.2023, ora 11:00, është paraqitur pranë subjektit ProAqua International, për të zhvilluar një intervistë pune, të cilën e kishte caktuar përmes aplikacionit *whatsapp*. Kur është afruar në adresën e ProAqua, sipas komunikimit me stafin që e kishte informuar mbi përzgjedhjen për intervistë, i ka telefonuar për të pyetur më në detaje mbi vendodhjen e zyrës ku do të intervistohet. Personi me të cilin ka komunikuar në telefon, pasi e dëgjoi duke folur, i kërkoi të hapte kameran dhe ta drejtonte atë nga vetja. Pasi nuk pranoi ta bënte një gjë të tillë, një punonjëse e ProAqua u afrua për ta shoqëruar në drejtim të zyrës.

Sapo ka hyrë në zyrë, personi me të cilin kishte folur në telefon (të cilin e njohu nga zëri, por edhe për faktin se punonjëset e tjera ishin vajza) i'u drejtua me fjalët: “Ti qenke pederast; qenke by\*hq\*rë”. E pyeti se përse po i drejtohej në atë mënyrë dhe personi i'u përgjigj “ti duhesh vrarë”.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Pas këtij momenti është larguar nga ambienti i ProAqua pa e zhvilluar intervistën e punës. Pas këtij momenti, përfaqësuesit e ProAqua bllokuan numrin e tij të kontaktit në aplikacionin whatsapp.

Pala ankuese shprehet se, këto deklaratat, përveçse tejet fyese dhe kërcënuese, pretendon se përbëjnë diskriminim të drejtëpërdrejtë për shkak të identitetit gjinor, gjatë procesit të rekrutimit, nga përfaqësuesi i ProAqua në cilësi personale, por edhe nga vetë subjekti ProAqua, në kuptim të nenit 12, pika b, e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Përfundimish, ankuesi kërkon nga Komisioneri, shqyrtimin e ankesës, kryerjen e një hetimi të plotë dhe konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë nga kompania ProAqua dhe përfaqësuesi i saj.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “**Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.**”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”, ndërsa në nenin 12, “*Ndalimi i diskriminimit*”, pika 1, gërma “b”, të po këtij ligji, parashikohet: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ..... b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;*”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe

sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1318/1 prot., datë 05.12.2023, Komisioneri, i është drejtuar në adresën e vendosur në dispozicion nga pala ankuese, subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa “ProAqua International”, duke e njoftuar për paraqitjen e ankesës dhe ka kërkuar nga ky subjekt parashtrimet në lidhje me pretendimet e ngritura dhe dokumentacionin përkatës. Subjekti “ProAqua Internatinal” nuk ktheu asnjë përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.
2. Me shkresën nr. 1318/2., datë 28.12.2023<sup>3</sup>, Komisioneri ripërsëriti kërkesën për informacion në drejtim të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa “ProAqua International” në adresën e vendosur në dispozicion nga pala ankuese. Subjekti “ProAqua Internatinal” nuk ktheu asnjë përgjigje.
3. Në kushtet kur, në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga pala ankuese, identiteti i subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa “ProAqua International”, nuk rezulton i provuar, Komisioneri, kryesisht realizoi verifikimet e mëposhtme me qëllim verifikimin e identitetit zyrtar të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa:
  - Kryesisht Komisioneri ka kryer verifikime në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit<sup>4</sup> (QKB) me qëllim verifikimin e identitetit të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa;
  - Nëpërmjet shkresës nr.163 prot datë 26.01.2024, Komisioneri iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), duke kërkuar informacion në lidhje me numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) dhe vendin e ushtrimit të aktivitetit, për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa;
  - Nëpërmjet shkresës nr.163/2 prot datë 08.02.2024, Komisioneri iu drejtua Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), duke kërkuar informacion në lidhje me subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa;

<sup>3</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr.281/3 prot., datë 03.04.2023.

<sup>4</sup> <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

4. Nga verifikimet e kryera nga Komisioneri në faqen zyrtare të internetit të QKB, nuk rezultoi i regjistruar asnjë subjekt me emërtimin “ProAqua International”.
5. Me shkresën nr.1777/1 prot, datë 05.02.2024, DPT, informoi Komisionerin se, asnjë subjekt me emër “ProAqua International/Pro-Aqua Internatinal” nuk figuron i regjistruar në organet tatimore.
6. Me shkresën nr.300/1 prot, datë 19.02.2024, ISHPSHSH, informoi Komisionerin se, nga verifikimi në sistemin *e-inspection* në rubrikën “Bizneset” nëpërmjet kërkimit me emrin tregtar “ProAqua International”, nuk rezulton asnjë e dhënë për këtë subjekt.
7. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 27.02.2024, Komisioneri bëri me dije palën ankuese, në lidhje me verifikimet e kryera me qëllim identifikimin e subjektit kundër të cilit pala ka paraqitur ankesë dhe faktin që, nga verifikimet e kryera nuk figuron i regjistruar ndonjë subjekt me emërtimin “ProAqua International”. Komisioneri kërkoi nga pala ankuese, që nëse dispononte informacione të tjera përveç atyre të depozituara së bashku me ankesën, të cilat mund të çojnë në zbulimin e identitetit zyrtar të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, t’i vendos në dispozicion të Komisionerit, brenda një afati kohor prej 10 (dhjetë) ditësh. Pala ankuese nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit informacione shtesë në lidhje me identifikimin e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 95 “Pamundësia në objekt apo qëllim”, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”

Komisioneri konstaton se, pavarësisht veprimeve të mësipërme verifikuese të ndërmarra nga ana e institucionit, nuk u bë e mundur identifikimi i subjektit kundër të cilit pala ankuese ka paraqitur ankesën. Në këto kushte, Komisioneri çmon se, objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura janë të pamundura, për sa kohë që subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk është identifikuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 254 regj, datë 23.11.2023, e paraqitur nga pala ankuese Xh.H, kundër Subjektit ProAqua International, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se

objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është i pamundur, për sa kohë që subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk është identifikuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.254 Regjistri, datë 23.11.2023, të paraqitur nga pala ankuese Xh.H kundër subjektit ProAqua International, për shkak se objekti dhe qëllimi i ankesës për të cilin ka nisur procedura është i pamundur.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Identiteti gjinor  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Ndërprerje procedure\_Pamundësi